



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të autoritetit të dhënë me nenin 63 dhe 103 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullën Zgjedhore nr. 06/2008 “Qendra e Numërimit dhe Rezultateve” (neni 4), Rregullën Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe Numërimi në Vendvotim” (neni 18), në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 14.11.2009 Miraton:

Procedurat

Për përgatitjen e materialit zgjedhor për pranim pas përfundimit të procesit të numërit në vendvotime për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009

- I. Përmes këtyre procedurave Këshillat e Vendvotimeve (KVV) si dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) obligohen që t’i zbatojnë në tërësi të gjitha veprimet e parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore të KQZ-së, më qëllim të numërimit të saktë, paraqitjes tabelare të saktë të rezultateve, futjes së shënimeve të sakta në formularët paraprakisht të përcaktuar si dhe paketimin e saktë të materialit zgjedhor pas përfundimit të zgjedhjeve.
- II. Nëse KKZ-ja me rastin e pranimit të materialit zgjedhor në depo të KKZ-ve, vërteton që në VV nuk janë numëruar rezultatet, nuk janë paraqitur në mënyrë tabelare, nuk janë paraqitur të dhënat në formularët përkatës apo nuk është bërë paketimi i materialit në pajtim me procedurat e parapara, KKZ-ja do të urdhëroi Kryesuesin/it e Vendvotimit/eve që t’i eliminoi parregullsitë.
- III. Nëse këto veprime nuk do të jenë plotësisht të zbatuara dhe materialet nuk janë të përpunuara dhe të përgatitura për pranim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), KQZ-ja do të urdhëroi QNR-në që të refuzoi pranimin e këtij materiali derisa ato të përpunohen në VV nga ana e KKZ-ve sipas procedurave të përcaktuara.
- IV. Në rast se QNR-ja në mënyrë të justifikuar refuzon pranimin e materialit për shkak të mos rregullimit të tij, KKZ-a do t’i kthej materialin në komunë dhe do të urdhëroi Këshillin e Vendvotimit që në prani të vëzhguesve dhe përfaqësuesve të partive politike t’i eliminoi parregullsitë përkatëse.
- V. Nëse Këshilli i Vendvotimit nuk e ka bërë numrin e Fletëvotimeve apo nuk i ka plotësuar formularët, KKZ-ja do t’i ftoi përfaqësuesit e partive politike dhe vëzhguesit e Vendvotimit përkatës dhe në praninë e tyre do të kompletoi procesin e numërimit dhe/ose evidentimin e rezultateve të votimit.
- VI. Për secilën nga veprimet e sipërpermendura Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe/ose Këshillat e Vendvotimeve obligohen të mbajnë shënime/raporte të detajuara.

VII. Dështimi për të zbatuar procedurën e sipërpermendur përbën shkelje dhe është i ndëshkueshëm sipas Kodit të Mirësjelles së KKZ dhe KVV-ve, dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës si dhe Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

VIII. Këto Procedura hyjnë në fuqi me datën 14.11.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

